



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 158, Datë 31.07.2024

MBI
DHËNIEN E GARANCISË SË ORIGJINËS PËR ENERGJINË ELEKTRIKE TË
PRODHUAR NGA PARKU FOTOVOLTAIK “BLUE 1” I SHOQËRISË “SPV BLUE 1”
SH.P.K.

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 22 të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; nenit 7 të Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme, miratuar nga bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) me vendimin nr. 229, datë 20.12.2019, e ndryshuar; nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, e ndryshuar; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.07.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1553/6 prot., datë 29.07.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k. për dhënie e garancisë së origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga parku fotovoltaik “Blue 1”,

Konstatohet se:

- Me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1553/2 prot., datë 28.06.2024 dhe nr. 1533/3 prot., datë 03.07.2024, shoqëria “SPV BLUE 1” sh.p.k. ka paraqitur kërkesën për lëshimin e Garancisë së origjinës për energjinë elektrike të prodhuar në muajin qershor 2024 nga parku fotovoltaik “Blue 1”.
- Referuar përcaktimeve të Rregullores për lëshimin, transferimin, tërheqjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme, e ndryshuar, Garancia e Origjinës për një impiant prodhues të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme lëshohet me bazë mujore ose vjetore sipas kërkesës së aplikuesit.
- Mbështetur në përcaktimet e nenit 22, pika 6 të ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, me shkresën nr. 1553/4 prot., datë 22.07.2024, ERE i është drejtuar Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., me kërkesën për informacion për sasinë e energjisë elektrike faktike të prodhuar nga ky impiant, për muajin qershor 2024 dhe numrin serial të aparatit matës.

- Në përgjigje, me e-mailin e protokolluar në ERE me nr. 1553/5 prot., datë 29.07.2024, OST sh.a. ka informuar se nga centrali fotovoltaik “Blue 1” gjatë muajit qershor 2024 (1-30) është prodhuar 10,657 MWh.
- Nga analizimi i aplikimit rezulton se shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar nga *Rregullorja për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme*, e ndryshuar.
- Për sa më sipër vlerësohet dhënia e Garancisë së Origjinës për energjinë e prodhuar nga parku fotovoltaik “Blue 1”, i shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k., për periudhën 01-30 qershor 2024, sipas sasive të dhëna nga OST sh.a., pra për 10,657 MWh.
- Në zbatim të përcaktimeve të nenit 22, pika 5 të ligjit nr. 24/2023 “*Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme*”, *Garancia e origjinës është e vlefshme për një vit duke filluar nga dita e fundit e periudhës së prodhimit për të cilën është lëshuar.*

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Dhënien e Garancisë së Origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga parku fotovoltaik “Blue 1”, i shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k., gjatë periudhës 01-30 qershor 2024, për sasinë 10,657 MWh.
2. Garancia e origjinës, e dhënë sipas përcaktimeve të këtij vendimi, është e vlefshme për 1 (një) vit duke filluar nga dita e fundit e periudhës së prodhimit për të cilën është lëshuar.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “SPV BLUE 1” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI